



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 392/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

**Vendim**

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerim Grainca nga radhët subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV) 2501X/08R.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e subjekti politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit fletëvotimeve është konstatuar se ka 48 vota në VV Nr. 2501X/08R, dhe me rastin e plotësimit të FRK-së numri i këtyre votave është shënuar tek kandidatja tjetër e radhës me numër 75, dhe se ky rezultat figuron ende në rezultatit përfundimtar.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit të QV me nr. 2501X/08R, Fahri Jashari.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë: *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme”, andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:*

## **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Blerim Grainca nga subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i 48 votave në FRK nga ana e komisionarëve të VV 2501X/08R dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me numër 75.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 2501XD/08R për Komunën e Ferizajt ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiritat anësor të kutisë kanë nr. 095957, 095958, 095959 dhe 095960 ndërsa shiriti i mesëm nr. 095955 i cili nuk ishte i prekur fare. Shiriti brenda kutisë votimit kishte nr. 113470.

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr. 76 nga radhët e subjektit politik LDK nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 2501X/08R nga hetuesit e PZAP-it del se i njëjti i posedon 47 vota të vlefshme.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklarata e anëtarit të KVV se është bërë gabim i paqëllimshëm gjatë plotësimit të FRK-së në QV 2501X/08R në Komunën e Ferizajt del se ka pasur një lëshim gjatë plotësimit të FRK-së në VV e cekur më lartë, me ç'rast numri i votave të kandidatit Blerim Grainca nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së.

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 të LZP-së, dhe nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 392/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*